



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 165 prot.

Kamëz, më 25.11.2022

V E N D I M
Nr. 141 .Datë 25/11 2022
M B I

“MIRATIMIN E MANUALIT TË PROCEDURAVE PËR RREGULLAT, MËNYRAT DHE AFATET E TRAJTIMIT TË INDIVIDËVE QË NDODHEN NË KUSHTE TË VËSHTIRA EKONOMIKE DHE NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË NË TREGUN E LIRË PËR VITIN 2023”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 25.11.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.125 Datë 22.11.2022 në mbështetje të Ligjit Nr 139 datë 17.12.2015 "Për Vetqeverisjen Vendore", Ligjit Nr 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile"; Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", VKM nr.362 datë 20.05.2019 "Për kriteret e dhënies subvencionimit qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij"; VKM nr. 459 datë 03.09.2019 "Rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive qeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionimit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet NJQV dhe ministrisë përgjegjëse për strehim"; Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Kamëz me nr.895 prot, datë 21.11.2022 "Ngritjen e Grupit të punës për ndjekjen dhe trajtimin të individeve që ndodhen në kushte të vështira ekonomike dhe nuk mund të përballojnë qiranë në tregun e lire brenda territorit të Bashkisë Kamëz"; **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e manualit të procedurave për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të individeve që ndodhen në kushte të vështira ekonomike dhe nuk mund të përballojnë qiranë në tregun e lirë për vitin 2023.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi i Punës i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë me nr.895 prot, datë 21.11.2022 "Për pranimin e kërkesave dhe administrimin e dokumentacionit të aplikanteve që kanë aplikuar për të përfituar nga programi "Subvencionimi qirasë" për vitin 2023.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

Manuali për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të individëve që ndodhen në kushte të vështira ekonomike dhe nuk mund të përballojnë qiranë në tregun e lirë në Bashkinë Kamëz për vitin 2023, paraqitet në ankesin bashkë-lidhur këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ**

Nr. ____ prot.

Kamëz, më ____ .11.2022

M A N U A L

**I PROÇEDURAVE PËR RREGULLAT, MËNYRAT DHE AFATET E
TRAJTIMIT TË INDIVIDIVE QË NDODHEN NË KUSHTE TË
VËSHTIRA EKONOMIKE DHE NUK MUND TË PËRBALLOJNË
QIRANË NË TREGUN E LIRË
PËR VITIN 2023**

TABELA PËRMLEDHËSE E MANUALIT

- Hyrje
- Përkufizime
- Kuadri Ligjor
- Struktura e ngarkuar për zbatimin e trajtimit të individëve që ndodhen në kushte të vështira ekonomike dhe nuk mund të përballojnë qiranë në tregun e lirë për Bashkinë Kamëz në zbatim të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”
Grupi i Punës
Këshilli Bashkiak
Komisioni i Strehimit
- Subjektet përfitues
- Mënyrat e trajtimit të të individëve që ndodhen në kushte të vështira ekonomike dhe nuk mund të përballojnë qiranë në tregun e lirë brenda territorit të Bashkisë Kamëz.
- Fazat nëpërmjet të cilave kalon një individ për tu konsideruar përfitues në zbatim të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”

HYRJE

Ky manual do të shërbejë si udhëzues për vënien në zbatim të bazës ligjore për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit nga Bashkia Kamëz të individëve që ndodhen në kushte të vështira ekonomike dhe nuk mund të përballojnë qiranë në tregun e lire brenda territorit të njësisë qeverisjes vendore Bashkia Kamëz në kuadër të zbatimit programi i banesave sociale me qira, në vijim BSQ, dhe në mungesë të tyre ofrimin e mundësisë me subvencionim qiraje mujore.

Qëllimi i manualit është zbatimi dhe unifikimi i rregullave si dhe procedurave të cilat duhet të ndjek Grupi i Punës i ngarkuar nga Kryetari i Bashkisë Kamëz, sipas Urdhërit me nr.895 prot. Datë 21.11.2022 për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen dhe trajtimin të individëve që ndodhen në kushte të vështira ekonomike dhe nuk mund të përballojnë qiranë në tregun e lirë brenda territorit të Bashkisë Kamëz.

Së fundmi, ky manual përcakton një kuadër rregullator për funksionimin me efikasitet dhe efikasitet të veprimtarisë së grupit të punës së ngritur sipas urdhërit të Kryetarit të Bashkisë, i cili do të jetë përgjegjës për trajtimin e subjekteve përfitues, në zbatim të legjislacionit aktual në fuqi që lidhen me çështjet e strehimit social, përmendim këtu ligji nr.22/2018 “Për Strehimin Social” dhe VKM-të përkatëse të nxjerra në zbatim të programit Social “Subvencionimi Qirasë për familjet që ndodhen në kushte të vështira Ekonomike dhe nuk mund të përballojnë qiranë në tregun e lire” në mungesë të banesave sociale me qira BSQ.

PËRKUFIZIME:

Në këtë manual termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Ligji”** - Ligji nr.22/2018 “Per Strehimin Social”;
2. **“VKM”** – Vendimi nr. 384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”;
3. **“Individ/familje në nevojë për strehim”** është individ/familja që ka banesë, por e ka nën normën e strehimit, që nuk ka të ardhura që të sigurojë pagesën për një qira të përballueshme në tregun e lirë.
4. **“Banesë sociale me qira”** është banesa që jepet me qira, në pronësi publike, nga fondi publik i banesave sociale, si dhe banesat që janë e mbeten në pronësi të subjekteve private, por që vihen në dispozicion të programit të banesave sociale me qira, me pëlqimin e pronarit privat.
5. **“I pastrehë”** është çdo individ/familje që nuk ka banesë, i cili/e cila banon në mjedise që nuk klasifikohen si vende për banim apo në një banesë të përkohshme, në kuptim të këtij ligji, dhe nuk ka mundësi ekonomike e financiare për të siguruar një banesë.
6. **“Subvencion i qirasë”** është shuma e të hollave që jepet nga institucionet shtetërore për llogari të përfituesit, me qëllim mbulimin e pjesës së qirasë, e cila nuk përballohet me të ardhurat e përfituesit.
7. **“Komisioni i strehimit”** është Komisioni që ngrihet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe ka në përbërje përfaqësues të komuniteteve të interesuara.
8. **“Përfitues”** - Subjekti i cili është njoftuar për aplikimet ne programin subvencionimit te qirase dhe ka plotësuar dokumentacionin e kerkuar ne zbatim te VKM-se nr.384 date 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore” dhe kategorizohet ne nje nga grupet jovulnerable sipas ligjit 22/2018 “Per Strehimin Social”;
9. **“Grupi i Punës”** -Është grupi i punës i ngritur me Urdhërin me nr.895 prot, datë 21.11.2022 nga Kryetari i Bashkisë Kamëz, i cili do të jetë përgjegjës për vënien në zbatim të bazës ligjore për zbatimin e procedurës së trajtimit të afateve për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit nga Bashkia Kamëz të individeve që ndodhen në kushte të vështira ekonomike dhe nuk mund të përballojnë qiranë në tregun e lirë brenda territorit të njësisë qeverisjes vendore Bashkia Kamëz.

KUADRI LIGJOR

Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

Ligji nr.44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative së Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;

Ligji nr.22/2018 “Për strehimin social”;

Vendimit nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit”,

Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”,

VKM nr.362 date 20.05.2019 “Për kriteret e dhënies subvencionimit qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”;

VKM nr. 459 datë 03.09.2019 “Rregullat për administrimin e kërkesave të njësive qeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionimit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet NJQV dhe ministrisë përgjegjëse për strehim”;

Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Kamëz me nr.895 prot, datë 21.11.2022 “Ngritjen e Grupit të Punës për ndjekjen dhe trajtimin të individeve që ndodhen në kushte të vështira ekonomike dhe nuk mund të përballojnë qiranë në tregun e lirë brenda territorit të Bashkisë Kamëz”;

Struktura e ngarkuar për zbatimin e programit të subvencionimit të qirasë për familjet që nuk mund të përballojnë dot qiranë në tregun e lirë:

Grupi punës i cili do të jetë përgjegjës për vënien në zbatim të bazës ligjore për zbatimin e procedurës së trajtimit të afateve për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit nga Bashkia Kamëz të individeve që ndodhen në kushte të vështira ekonomike dhe nuk mund të përballojnë qiranë në tregun e lirë brenda territorit të njësisë qeverisjes vendore Bashkia Kamëz, do të jetë si më poshtë:

- Enkeleda Brati Përgj. Dr. Emergjencave Civile dhe Strehimit
- Antigona Lleshi Sp. Dr. Emergjencave Civile dhe Strehimit
- Dorina Koçeku Sp. Dr. Emergjencave Civile dhe Strehimit

Grupi i punës i legjitimuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë me qëllim trajtimin e subjekteve që individeve që ndodhen në kushte të vështira ekonomike dhe nuk mund të përballojnë qiranë në tregun e lirë brenda territorit të njësisë qeverisjes vendore Bashkia Kamëz, kanë përgjegjësinë për të trajtuar:

1. Trajtimin financiar në formën e bonusit të qirasë nga momenti i shqyrtimit të dosjes nga Komisioni Strehimit dhe Konfirmimit të vendimit të listës së përfituesve nga Këshilli Bashkiak.

Grupi i punës do të kujdeset për njoftimin e subjekteve të përfituesve që do të trajtohen përmes bonusit të qirasë në mungesë të banesave sociale.

Grupi i punës administron informacionin/ dokumentacionin e nevojshëm të subjekteve përfitues që kanë plotësuar dokumentacionin e kërkuar dhe subjekteve jo përfitues që nuk plotesojnë kushtet për të përfituar nga programi strehimit social nëpërmjet shkresës zyrtare nga Bashkia Kamëz.

Grupi i punës harton Raportin Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë, në të cilën detajohen procedurat e ndjekura dhe listën e subjekteve përfituese, e cila i paraqitet për miratim Këshillit Bashkiak.

KOMISIONI STREHIMIT

Komisioni Strehimit realizon funksionet e mëposhtme:

- Shqyrton kërkesat dhe dokumentacionin e administruar nga sektori strehimit të subjekteve të ndryshëm që kanë aplikuar dhe kanë mbledhur dokumentacionin për të përfituar nga programi subvencionimit të qirasë;

- Komisioni Strehimit harton një raport permbljedhës përfundimtar me listën e subjekteve që plotësojnë kushtet sipas ligjit për strehimin social nr.22/2018 “Për Strehimin Social” dhe listën e subjekteve që nuk mund të plotësojnë kushtet ose dokumentacionin e duhur në zbatim të legjislacionit në fuqi.
- Komisioni Strehimit mban një procesverbal për të gjithë procedurën e shqyrtimit të dosjeve individuale të aplikantëve.
- Procesi i përzgjedhjes së përfituesve finalizohet me zbardhjen e proces-verbalit përkatës pjesë e të cilit është edhe lista përfundimtare e individëve që nuk perballojnë dot qiranë në tregun e lirë. Grupi i punës, paraqet procesverbalin e mbledhjes së bashku me listën përfundimtare të përfituesve. Njëkohësisht, Grupi i Punës harton Raportin Përmbledhës i cili i përcillet Kryetarit të Bashkisë dhe e informon në lidhje me listën e subjekteve që përfitojnë nga VKM.

KËSHILLI BASHKIAK

- Miraton listën përfundimtare të përfituesve ku përcaktohet qartë forma e trajtimit të subjekteve;
- Miraton vlerën e subvencionimit të qirasë dhe nivelit të qirasë sipas vlerës së tregut për familjet që nuk mund të përballojnë dot qiranë në tregun e lirë.

SUBJEKTET PËRFITUES

Eshtë përfitues individ i cili gjendet në një nga kushtet e mëposhtme:

Statusin e përfituesit nga programet sociale, e gëzon çdo individ që ka mbushur moshën 18 vjeç dhe familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore perkatesisht ne Bashkine Kamez, të cilët në momentin e aplikimit plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) nuk kanë në pronësi një banesë ose zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit apo banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi, për të cilat normat e strehimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) kanë mbetur të pastrehë, si rezultat:

i) i fatkeqësive natyrore;

ii) i prishjes së objekteve të pakualifikuara si banesë;

iii) i zhvendosjeve për shkak të investimeve publike dhe nga objektet e përjashtuara nga procesi i legalizimeve;

iv) nga zbatimi i akteve administrative dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë;

c) familjet që kanë një banesë të vjetër, në rrezik shembjeje, ose një banesë që i nënshtrohet një plani rregullues, për shkak të vjetërsisë së saj.

2. Përfitojnë nga programet e strehimit social të këtij ligji edhe shtetas të huaj, me qëndrim të rregullt në Shqipëri dhe që kanë përfituar nga organet kompetente statusin si “punëtor emigrant” dhe/ose “azilkërkues”

Nuk është përfitues subjekti i cili ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme:

- a) Subjekti i cili ka në pronësi ose posedim të ligjshëm më shumë se një banesë, brenda juridiksionit territorial të shtetit Shqiptar;
- b) Nuk plotëson dokumentacionin e kërkuar në zbatim të VKM nr. 384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore;
- c) Subjekti i cili ka të ardhura të larta me tepër se atyre të përcaktuara në ligjin për strehimin social dhe nuk plotësojnë kushtet sipas nenit 16 të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”;
- d) Subjekti i cili nuk është banor pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore Bashkisë Kamëz;

MËNYRAT E TRAJTIMIT TË FAMILJEVE QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË DOT QIRANË NË TREGUN E LIRË:

- a) **Trajtim përmes fondit të banesave, në zbatim të ligjit nr.22/2018 “Per Strehimin Social ;**

Fondi i Banesave që do të vendoset në dispozicion për trajtimin e përfituesve, do të jetë nga tërësia e banesave në pronësi të Bashkisë Kamëz të përfituara sipas ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”, apo forma të tjera të parashikuara nga aktet ligjore apo nënligjore në fuqi.

- a) **Trajtimin financiar në formën e bonusit të qirasë për një afat 1- vjeçar nga momenti i plotësimit të dokumentacionit në zbatim të VKM-së nr. 384 datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”;**

Statusin e përfituesit nga programet sociale, sipas këtij ligji, e gëzon çdo individ që ka të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, i cili ka mbushur moshën 18 vjeç dhe familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilët në momentin e aplikimit plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) nuk kanë në pronësi një banesë ose zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit apo banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi, për të cilat normat e strehimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) kanë mbetur të pastrehë, si rezultat:

i) i fatkeqësive natyrore;

ii) i prishjes së objekteve të pakualifikuara si banesë;

iii) i zhvendosjeve për shkak të investimeve publike dhe nga objektet e përjashtuara nga procesi i legalizimeve;

iv) nga zbatimi i akteve administrative dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë;

Niveli i qirasë mesatare në treg të lirë sipas strukturave të aparatamenteve në territorin e Bashkisë Kamëz miratohet nga Këshilli Bashkiak Kamëz. Masa e subvencionit është në varësi të nivelit të të ardhurave të familjes. Subvencioni mund të mbulojë deri në 100 për qind të qirasë sociale, për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ato që janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, pavarësisht nëse nuk e kanë përfituar atë, dhe që strehohen në banesa sociale me qira. Forma e trajtimit me Bonus Strehimi përfshinë dhe mbështetë të gjithë individët dhe familjet që kanë vendbanimin e tyre në territorin e Bashkisë Kamez,

Nr.	Emërtimi	Njësia	Nr. frymësh	Sasia	Çmimi mesatar(lekë pa TVSH)
1	Banesa me qira (Apartament tip garsionerë)	Muaj	1-2	1	18,000
2	Banesa me qira (Apartament 1+1)	Muaj	3-4	1	21,000
3	Banesa me qira (Apartament 2+1)	Muaj	5	1	25,000
4	Banesa me qira (Apartament 3+1)	Muaj	6-8	1	27,000

Me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet që kanë nevojë për strehim, përmes subvencionimit të qirasë si instrument i programit të banesave sociale me qira, në mungesë të fondit të banesave Bashkia Kamëz ofron mundësinë e subvencionimit të qirasë mujore duke ju siguruar mundësinë për të përballuar qiranë në vlerën e tregut për të gjitha ato familje të cilat nuk mund të përballojnë dot qiranë në tregun e lirë.

Për të përcaktuar nivelin e qirasë mujore i jemi drejtuar agjensive imobiliare “**Remax**”, “**Vero Home**” “**Sarai**” “**Golden Home**”, të rregjistruar pranë organeve tatimore si subjekte që ofrojnë shërbime imobiliare për të përcaktuar nivelin e qirasë për Apartament tip garsonierë, apartament tip 1+1, 2+1 dhe 3+1 nga të cilët vetëm 3 subjekte kanë dhënë informacionin e kërkuar dhe në bazë të këtij informacioni kemi llogaritur vlerat e qirave për të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz sipas strukturave të apartamenteve, si më poshtë:

Vlera e subvencionit të qirasë mund të jetë deri në 100 për qind e vlerës së qirasë mesatare të banesave në tregun e lirë për njësinë e vetëqeverisjes vendore ku jepet ky subvencion. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë përcaktohet çdo vit, bazuar në të dhënat e vitit të mëparshëm, dhe miratohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Pagesa që duhet të bëjë familja për diferencën ndërmjet qirasë së tregut dhe vlerës së subvencionimit të qirasë nuk duhet t'i kalojë 25 për qind të të ardhurave të familjes. Mënyra e llogaritjes së vlerës së subvencionimit të qirasë në tregun e lirë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

SISTEMI PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN E “SUBVENCIONIMIT TË QIRASË NË TREGUN E LIRË”, PËR FAMILJET QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË NË TREGUN E LIRË.

Përzgjedhja e subjekteve dhe familjeve përfituese bëhet nëpërmjet një sistemi pikëzimi, i cili miratohet dhe publikohet për çdo program nga njësia e vetëqeverisjes vendore, bazuar në parimet e parashikuara në këtë ligj, si dhe kriteret e bëra publike përpara fillimit të procesit të aplikimit. Në përzgjedhjen e subjekteve përfituese me anë të sistemit të pikëzimit përfshihen individë/familje, të cilët përmbushin nivelin e të ardhurave të parashikuara sipas çdo programi.

Përparësi në subvencionimin e qirasë sipas sistemit të pikëzimit kanë, por pa u kufizuar në to, kategoritë e mëposhtme:

- a) individët me statusin e jetimit;
- b) personat me aftësi të kufizuara;
- c) të moshuarit;
- ç) invalidët e punës;
- d) familjet e policëve të rënë në detyrë;

- dh) emigrantët e rikthyer;
- e) punëtori emigrant;
- ë) azilkërkuesit;
- f) familjet e komunitetit rom;
- g) familjet e komunitetit egjiptian;
- gj) Viktimat e dhunës në familje;
- h) viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit;
- i) prindërit e vetëm, që kanë në ngarkim fëmijë;
- j) individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të cilët janë viktima për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi që përcakton se si pasojë e diskriminimit individi nuk ka një strehim të përshtatshëm dhe që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 3 të këtij ligji;
- k) të miturit, 14-18 vjeç, dhe të rinjtë, 18-21 vjeç, në konflikt me ligjin, kur dalin në lirim pas kryerjes së dënimit, kur kanë nevojë për banesë, sepse duhet të jetojnë larg familjeve, për shkak të rehabilitimit të tyre më të mirë në shoqëri;
- l) vajzat nëna, pas daljes nga programi i banesave sociale të specializuara;
- ll) familjet me statusin e qiramarrësit në banesa ish-pronë private, sipas aktit normativ nr. 3, datë 1.3.2012

Tabela. 1

SISTEMI I PIKËZIMIT PËR TRAJTIM SIPAS PROGRAMIT TË BANESAVE SOCIALE ME QERA		
NR.	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	30

A	Kane ngelur te pastrehe si rezultat i zbatirnit te Aktit Normativ te Qeverise Nr.3 date 01.08.2012 "Per lirirnin e banesave pronarëve te ligjshem nga qytetaret e pa strehe, banues në ish-prone e subjekte te shpronesuara,' me apo pa kontrate nga shteti	15
B	Kane ngelur te pastrehë si rezultat i fatkeqsive natyrore , ose te zbatimit te nje vendimi gjyqësor	4
C	Banojne ne banesa me rrezik shëmbetje sipas percaktive ligjore dhe rezikojne te ngelen te pastreha	4
Ç	Banojne në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave ne fuqi	4
D	Nuk disponojne banesë ne pronesi	3
1.2	KUSHTET FAMILJARE	20
A	Të moshuar që kane mbushur moshën e pensionit dhe që nuk perzgjidhen per t'u strehuar nga institucionet publike të përkujdesit shoqëror.	5
B	Familjet me më shume se kater femije ose familje një prindërore qe kane femije ne ngarkim	7
C	Çiftet e reja me moshe totale deri në 60 (gjashtedhete) vjeç	3
Ç	Familje te komunitetit Rom dhe Egiptian	5

1.3	KUSHTET SOCIALE	20
A	Personat me aftesi te kufizura, në përputhje me përcaktimet e bera rne Vendim të Këshillit te Ministrave për këto kategori	5
B	Personat me status jetim qe nga çasti i daljes nga qendrat e perkujdesjes shoqërore e deri ne moshen 30 vjeç	5
C	Emigrant i kthyer, punetor emigrant, famile që kanë ne perberje persona te cilet gezojne statusin e ish te pëmdjekurve politik	2
Ç	Familje të policeve te rënë ne detyrë	4
D	Viktimat të dhunës në familje	4
1.4	KUSHTET EKONOMIKE	30
A	Të ardhura nën 80% te te ardhurave mesatare	15
B	Të ardhura nga 80% deri në 100% te te ardhurave mesatare	10
C	Te ardhura nga 100% deri ne 120% te te ardhurave mesatare	5

Aneksi 2

Menyra e vlersimit dhe llogaritja:

Shënim:

Nuk mund të mblidhen brenda për brenda një kriteri pikët:

1. Nga A deri në Q të kriterit 1.1;
2. Nga A deri në Q te kriterit 1.2; dhe
3. Nga A deri ne C te kriterit 1.4.

Piket nga A deri ne D te kriterit 1.3 mund te mblidhen me njera-tjetren sipas rasteve më poshtë:

1. pika A mund te mblidhet me njerin prej rasteve si me poshte:

a) Me pikat B dhe Q së bashku ose veçmas;

b) Vetem me Piken C;

c) Vetëm me Pikën D.

2. Pika B mund te mblidhet vetem me piken A.

3. Pika C mund te mblidhet vetem me piken A.

4. Pika Q mund te mblidhet me pikat A e B se bashku ose me njerin prej tyre. Ne total mbledhja e pikeve A, B e Q nuk duhet te rezultojë me e larte se 20 pike.

***Shenim:** Bazuar në Ligjin 22/2018 “Per Strehimin Social” Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit ka hartuar sistemin e pikëzimit sipas prioriteteve, kriterëve parimeve që përcaktohen në këtë ligj sipas tabelës nr.1 dhe Aneksi 2 me siper. Pas miratimit të sistemit të pikëzimit nga Këshilli Bashkiak, Bashkia Kamëz e publikon në website-in e saj dhe rrjetet e tjera sociale këtë sistem. Brenda një afati 1 muajor bëhet vlerësimi i dosjeve të secilit aplikant nga Komisioni i Strehimit në Bashkinë Kamëz sipas sistemit të pikëzimit të miratuar. Përpilohet lista e aplikantëve në rend zbritës sipas pikëve të marra. Lista përfundimtare miratohet në Këshillin Bashkiak.

FAZAT NËPËRMJET SË CILËS KALON PROCEDURA PËR TË PËRFITUAR NGA PROGRAMI SUBVENCIONIMIT TË QIRASË

Faza e parë:

Kamëz, më __.11.2022

NJOFTIM

Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; ligjit nr. 22/2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar; VKM-në nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”; VKM nr.459, datë 03.07.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për

subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”; shkresa nr.8552 datë 14.05.2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Ju informojmë se:

Bashkia Kamëz hap ***aplikimet për programet e strehimit social i cili do të kryhet online nga vet i interesuari në platformën e-albania duke filluar që nga data ___/___/2022***

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin,

****Shenim:*** Aplikimi bëhet sipas formatit të caktuar nëpërmjet portalit e-albania, në ditën “Kërkesa për programet sociale të strehimit social”. Grupi i punës i cili është përgjegjës për ndjekjen e të gjitha procedurave, duhet të përfundojë brenda afateve kohore të gjithë rregjistrimin e kërkesave të aplikantëve, si dhe të asistojë të gjithë aplikuesit me ndihmën e nevojshme për të kryer aplikimin online nëpërmjet portalit e-albania me sukses.

FAZA DYTE:

Kamëz, më ___/___/2022

NJOFTIM!

Referuar ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" ligjit nr. 22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social” i ndryshuar; VKM-në nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”; VKM nr.459, datë 03.07.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”.

Njoftohen të gjithë familjet e pastreha të Bashkisë Kamëz, që janë shpallur fitues për fazën e parë dhe duan të aplikojnë për fazën e dytë të programit Subvencionin i qirasë për familjet në nevojë që nuk mund të përballojnë qiranë në tregun e lirë për vitin 2022, të paraqiten pranë

institucionit të Bashkisë Kamëz në sportelin One Stop Shop për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm për të përfituar nga ky program.

Afati për aplikim në programin e Subvencionit të qirasë do të jetë nga data __/__.2022 deri më __/__.2022, në sportelin One Stop Shop.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

**Shenim* Grupi i punës bën vlerësimin e formularit tip, ku bën njoftimin e aplikuesve që përmbushin kriteret për të përfituar bonus strehimi si dhe ato të cilët nuk rezultojnë të suksesshëm sipas akteve ligjore të përcaktuara,

Familjet që rezultojnë të suksesshme në fazën e parë të aplikimit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga momenti i njoftimit, dorëzojnë dokumentacionin e nevojshëm për tu trajtuar me bonus strehimi. Dorëzimi i dokumentacionit realizohet nga familjari aplikues pranë Sektorit të Informimit dhe Shërbimeve për Qytetarët, pranë Njesisë Qeverisjes Vendore Bashkia Kamez.

LISTA E DOKUMENTACIONIT QË DUHET TË KETË ÇDO DOSJE E SUBJEKTIT PËRFITUES PËR TË PËRFITUAR NGA PROGRAMI SUBVENCIONIMIT QIRASE:

1. Çertifikata e lindjes së aplikantit dhe çertifikatën e gjendjes familjare;
2. Vërtetimin për vendbanimin në bashkinë ku kërkohet strehimi ose lejen e banimit, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit;

Për të ardhurat për gjithë personat mbi 18-vjeç të familjes

1. Vërtetimi i të ardhurave neto dhe bruto (vërtetim punësimi nga punëdhënësi)
2. Vërtetimin nga Drejtoria Rajonale Tatimore për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes; *(e-albania)*,
3. Dokumentin që ske biznes nga organet tatimore *(e-albania)*,
4. Vërtetimin nga zyra e ndihmës dhe përkuqdesjes sociale pranë njësive të qeverisjes vendore për anëtarët e familjes, të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuar;
5. Vërtetimin nga zyra e punësimit e njësive vendore përkatëse për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë;
6. Dokumentin e zyrës punes per personat e papune mbi 18-vjeç
7. Vërtetimin nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension;

Për pronësinë për gjithë personat mbi 18-vjeç të familjes

1. Vërtetimin nga ASHK(Agjensia Shtetërore e Kadastrës) se familja apo ndonjë anëtar i saj nuk disponojnë në pronësi banesë a ndonjë mjedis, që mund të përdoret si e tillë; *(e-albania)*,
2. Vërtetimin nga ASHK(Agjensia Shtetërore e Kadastrës për sipërfaqen e pronës, që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj, kur banesa është me sipërfaqe nën normat në fuqi të strehimit;
3. Vërtetimin nga ASHK(Agjensia Shtetërore e Kadastrës të vendit të **origjinës** se nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për familjet, që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi, për të gjithë anëtarët e familjes; *(e-albania)*,
4. Vërtetim nga ALUIZNI që personat e familjes skane prone ne proces legalizimi.
5. Vërtetim për aplikim për legalizim ndërtimi informal.*(e-albania)*

Për gjendjen sociale të secilës familje (sipas rastit)

1. Dokumentin zyrtar të celebrimit dhe certifikatat personale, për efekt të llogaritjes së moshës, për çiftet e reja;
2. Vendimin e gjykatës, që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara, shoqëruar me vërtetimin nga zyra e përmbarimit për masën e pensionit që përfitojnë për fëmijët;
3. Vërtetimin përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezën e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror i autorizuar, për individët me statusin e jetimit;
4. Vërtetimin e Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Aftësisë së Kufizuar, për individë me aftësi të kufizuara, që trajtohen sipas shkronjës “i”, të shkronjës “c”, të nenit 5, të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar;
5. Nëse jetoni në një banesë me kushte jo të mira ose që rrezikon shembjen, kopja origjinale e vërtetimit të lëshuar nga Shërbimet Teknike të Bashkisë;
6. Dokumentin e lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin “emigrant”, “punëtor emigrant” dhe “azilkërkues”;
7. “Emigranti” dhe “punëtori emigrant”;
8. Vërtetim nga sportelet e migracionit të Ministrisë së Punëve, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, ose
9. Vërtetim nga zyrat e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, ose
10. Vërtetim i marrë pranë zyrave të punës.
11. “Azilkërkues”;
12. Vërtetim nga Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët.
13. Dokumentin e lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e punonjësve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe Policisë së Burgjeve:

14. Vërtetim nga Policia e Shtetit;
15. Vërtetim nga Garda e Republikës;
16. Vërtetim nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm;
17. Vërtetim nga Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit;
18. Vërtetim nga Forcat e Armatosura;
19. Vërtetim nga Shërbimi Informativ Shtetëror;
20. Vërtetim nga Policia e Burgjeve.
21. Dokumenti i lëshuar nga institucionet përkatëse për viktimat e dhunës në familje;
22. Urdhri i mbrojtjes i lëshuar nga gjykata e rrethit gjyqësor, seksioni familjar (Fotokopje e njehsuar me origjinalin), ose
23. Vërtetim të marrë nga qendra kombëtare e shërbimit të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje - e ngritur nga Ministria e Punëve, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, ose
24. Dokumentacioni përkatës mjekësor i miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe raporti mjekësor i lëshuar nga shërbimet e urgjencës dhe qendrat shëndetësore në bashki dhe komuna, ose;
25. Vërtetim nga strukturat e shërbimit social, qendrave sociale dhe të rehabilitimit për viktimat e dhunës pranë njësive të qeverisjes vendore.
26. Dokumentin e lëshuar nga institucionet përkatëse për familjet e komunitetit rom.

27. Kontrate qiraje me të gjitha përcaktimet e duhura.

**Shenim:* Cdo aplikant do të sqarohet nga sektori strehimit për mënyrën dhe informacionet e nevojshme duke dhënë asistencën e duhur për të plotësuar dokumentacionin në mënyrë të rregullt.

ADMINISTRIMI DHE SHQYRTIMI DOKUMENTACIONIT

Për cdo subjekt që kalon fazën e parë, dhe është lajmëruar nga grupi punës për dorëzimin e dokumentacionit për fazën e dytë duhet krijuar një dosje e veçantë ku të administrohet dokumentacioni i referuar si më sipër.

Për çdo subjekt në dosjet përkatëse duhet të mbahet procesvebali i të gjithë dokumentacionit që administrohet nga grupi i punës.

Drejtoria e Strehimit Social realizon shqyrtimin e çdo praktike të dorëzuar nga aplikuesi sipas akteve ligjore dhe i propozon për vlerësim dhe shqyrtim të mëtejshëm në Komision Strehimit i cili në perfundim të shqyrtimit të dosjes individuale të secilit aplikant del me një raport ku në të përcaktohen subjektet e kualifikuara me dosje të plota të cilët do të kalojnë për miratim në Keshillin Bashkiak. dhe subjektet me dosje jo të plota që quhen të skualifikuara.

Grupi i punës duhet të mbajë një libër protokolli te brendshem ku të evidentohen të dhënat dhe kerkesat e te gjithë aplikanteve.

Për çdo subjekt përfitues duhet administruar në dosje nje flete inventari ku te permbaje te gjithë dokumentacionin e nevojshëm që kërkohet në zbatim të VKM-së nr. 384 datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”;

Brenda një muaji nga data e miratimit nga komisioni i strehimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore të listës së individëve/familjeve që përfitojnë nga subvencionimi i qirasë së banesave në treg të lirë, subjekti përfitues depoziton pranë komisionit të strehimit kontratat e qirasë të lidhura ndërmjet tij dhe pronarit social. Në rastet kur subjekti përfitues nuk e depoziton kontratën brenda afatit 1-mujor, komisioni shtyn afatin me 30 ditë.

Nëse edhe pas këtij afati shtesë subjekti përfitues nuk depoziton kontratën, ai humbet të drejtën për të vijuar procedurën. Subjekti ka të drejtë të aplikojë përsëri në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë ligj.

Pas depozitimit të kontratave të qirave të subjekteve përfituese, komisioni i strehimit i përcjell këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore listën dhe kontratat e qirasë, me qëllim që ai të vendosë miratimin e vlerave konkrete të subvencionit të qirasë për çdo përfitues. Mbledhja e këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore zhvillohet jo më vonë se një muaj nga data kur mbërrijnë listat e miratuara nga komisioni i strehimit.

Subvencioni i qirasë do t'i jepet përfituesit që nga data e lidhjes së kontratës, pavarësisht nga data e miratimit të vlerës së subvencionit për përfituesin konkret. Subvencioni i qirasë rinovohet çdo vit, sipas kontratës së qirasë dhe të ardhurave të deklaruara të familjes.

- MIRATIMI I LISTËS PËRFITUESE NË KËSHILL BASHKIAK

Drejtoria e Strehimit Social, dërgon për miratim në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, Kamez, listën e përfituesve për Bonus Strehimi. Këshilli Bashkiak Kamëz miraton në mënyrë përfundimtare, listën e përfituesve të mundshëm në formatin sipas tabelës nr.1 si më poshtë:

Nr	Emer Atesi Mbiemer	ID	Njesia Administrative	Numri Antarëve	Shuma
1					
2					
3					
4					

- FAZA PERFUNDIMTARE

Çdo familje e cila nuk përmbushur kriteret për të qënë pjesë e listës fituese, njoftohet zyrtarisht me shkresë nga ana e Drejtorisë së Strehimit Social.

**Shënim:* Njoftimi i subjekteve përfitues duhet realizuar nëpërmjet njoftimit zyrtar (shkresë zyrtare) dhe në kushtet kur subjekti që mban statusin e përfituesit nuk merr dijeni apo refuzon të marrë njoftimin në këto raste njoftimi bëhet me shpallje në këndin e njoftimeve publike konform parashikimeve ligjore në fuqi për njoftimet me shpallje publike. Për çdo subjekt përfitues hartohet njoftimi i përfitimit sipas formatit të mëposhtëm Shtojca C:

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE

Pas procesit të njoftimit të subjekteve jopërfitues dhe përfitues lista me konfirmimin ligjor nga ana e prefektit të Tiranës, dhe konfirmimi vendimit të Këshillit Bashkiak i percillet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për bashkëfinancim në raportin 80% MFE dhe 20% buxheti Bashkisë Kamëz.

SHTOJCA C



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE DHE STREHIMIT

Nr. _____ prot.

Kamëz, më ____ 2022

Lënda: Njoftim

Emër Mbiemër

Adresa:

Nr.tel

E nderur Znj. _____

Ju keni paraqitur kërkesen tuaj për tu trajtuar sipas programit të subvencionimit të pagesës së qerasë në tregun e lirë pranë Bashkisë Kamëz më datë __/__/2022.

Pas paraqitjes së kësaj kërkesë jeni njohur me listën e dokumentacionit që duhet të plotësoni për të përfituar nga ky program sipas nenit nr.14 të Ligjit 22/2018 “ Për Strehimin Social” ,pikës nr.16 të VKM nr Nr.384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”

Duke qenë se Ju nuk keni plotësuar dokumentacionin e duhur të përcaktuar sa më sipër, edhe pse jeni njoftuar disa herë nga sektori i strehimit nëpërmjet telefonit ju njoftojmë se s’kualifikoheni nga e drejta për të përfituar nga programi i subvencionimit të pagesës së qerasë në tregun e lirë për vitin 2022.

Duke Ju falenderuar për mirkuptimin,